



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:317643

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06638736

**C.nr.4334/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditësit: A.A. nga Mitrovica, përfaqësuar nga Gazmend Ismaili av me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës: Trepça SH.A me seli Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arianit Voca, me objekt të kontestit: Anulim i vendimeve dhe kthimi në pozitën paraprake të punës, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesore të dt. 18.12.2024, me datën 23.12.2024, nxjerr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.A. nga Mitrovica, **ANULOHEN** si të kundërligjshme vendimet e nxjerra nga e paditura dhe atë: Vendimi me nr.5794 i datës 25.09.2024 i nxjerr nga U.D i Krye shefit Ekzekutiv të Trepça SH.A me të cilin vendim paditësi si Drejtues i njësisë së përpunimit të xehës, nga njësia biznesore Miniera me Flotacion Trepça-Stantërg, transferohet në njësinë biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë si Udhëheqës i procesit Teknologjik dhe Vendimi me nr.6285 i datës 15.10.2024 i nxjerr nga Komisioni i ankesave me të cilin vendim paditësit i është refuzuar ankesa e datës 02.10.2024.

**II. DETYROHET** e paditura, që paditësin ta kthej në pozitë mëparshme të punës si Drejtues i njësisë së përpunimit të xehës në njësinë biznesore Miniera me Flotacion Trepça-Stantërg në pajtim me Kontratën e punës, nga njësia biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

**III. DETYROHET** e paditura: Trepça SH.A, t'ia paguajë paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 394.00 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarit, ka paraqitur padi pranë kësaj gjykatë me datën 07.11.2024, kundër të paditurës: Trepça SH.A me seli në Mitrovicë, me objekt të kontestit: Anulim Vendimi dhe kthim në pozitën paraprake të punës.

Gjykata pras pranimit të lëndës ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

I autorizuari i paditësit përgjatë shqyrtimit kryesore si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadiisë, duke vlerësuar se vendimet e atakuar me padi janë në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 17 par. 2 dhe 3 i Ligjit të Punës, e lidhur me nenin 33

par. 3 të Rregullores për Marrëdhënia e Punë në Trepça SH.A, pasi që për tu bërën një transferim nga një njësi biznesore, në një njësi tjetër biznesore duhet paraprakisht të plotësohen në mënyrë komulative dy kushte dhe atë: të ekzistojë kërkesa e udhëheqësit të njësisë biznesore në të cilën transferohet punonjësi si dhe duhet të ekzistojë aprovimi- pëlqimi i udhëheqësit të drejtpërdrejt të punonjësit, në rastin konkret deri me datë 25.09.2024 si udhëheqës i drejtpërdrejt i paditësit ka qenë Gëzim Mustafa- Drejtor i Flotacionit, këtë fakt e vërteton komunikimi elektronik- email-i ku udhëheqësi i drejtpërdrejt i paditësit në këtë email thekson se nuk ka pas ndonjë kërkesë – paralajmërim apo informim për transferon e paditësit në një njësi tjetër biznesore.

Si palë paditëse theksojmë faktin se paditësi A.A., sipas kontratës së punës me nr. Protokollin 997, ka qenë i caktuar në punë përkatësisht detyrat e punës Drejtues në Njësinë e përpunimit të xehës Miniera me Flotacion Trepça Stanterg, në nenin 4 të kontratës përcaktohet se të punësuarit i vazhdohet kontrata e punës në vendin e ri të punës në kohe të pacaktuar duke filluar nga data 01.10.2020 e tutje, lidhur me këtë vlerësojmë se e paditura ka vepruar në kundërshtim dhe me dispozitat e kontratës së punës, po ashtu vendimi për transfer ndaj paditësit për të cilin në pjesën e arsytimit e padituria referohet organizimit të ri të vendeve të punës, ky konstatim së pari nuk është vërtetuar nga pala e paditur se e njëjta ka nxjerr ndonjë akt juridik- vendim për fillim të organizimit të ri të vendeve të punës ose ristrukturimit si dhe duke përcaktuar kritere për një proces të tillë, lidhur me këtë ka shtuar faktin se vet e paditura në një dokument zyrtar me nr. Protokollin 1759, me titullin Informate konstaton se procesi i sistematizimit do të përfundojë me datë 30.04.2023, të cilin ja kanë dorëzuar gjykatës si provë.

Më tutje ka shtuar se gjykatës në cilësinë e provës materiale së bashku me padinë është dorëzuar dhe dokumentin- Vlerësimi i kryerjes së punës të lëshuar nga e paditura, e që ky dokument mbanë datën 11.01.2024, duke pasqyruar performancën e kryerjes së detyrave të punës nga paditësi, ku nga totali i arritshmëris del se paditësi ka përmbushur detyrat e tij të punës dhe ka pasur performancë prej 95.2%. Vendimet e të paditurës po ashtu bien ndesh dhe me pjesën e dispozitës ligjore të nenit 17 par. 2 të Ligjit të Punës ku paditësi i është ulur niveli i pagës dhe i njëjti është degraduar në raport me pozitën paraprake të punës, por që të njëjtën kërkesë e tërheq.

Gjykatës i propozojmë që të aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar që të anulohen vendimet me nr.5991 dhe 3053 të nxjerra nga Trepça SH.A, pasi që janë nxjerrë në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe në kundërshtim të kualifikimit dhe përvojën e paditësit, e po ashtu në kundërshtim me nenin 33 të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Trepça SH.A.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së Odës së Avokatëve dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104€, për dy seanca të mbajtura shumë prej 270.00€ si dhe për taks gjyqësore prej 20 €.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi, përgjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbesin në tersi pranë përgjigjes në padi ashtu që e kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit. Vlen të theksohet se është i pakontestueshëm fakti se vendimi lidhur me transferin e ka bazën e plote ligjore dhe i njëjti është marrë duke u bazuar në Ligjin për Trepçën dhe statusin e saj dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Në nenin 21 par. 2 nën paragrafi 2.1 e lidhur me nenin 22 par 3 dhe 4 i Statutit të Trepça Sha. A, ku cek se bordi menaxhues i shoqërisë përbehet nga krye shefi ekzekutiv, zëvendësi i tij dhe udhëheqësi i njësisë biznesore, ndërsa neni 22 par 3 i po të njëjti statut cek se detyrat, përgjegjësit dhe organizimi i shoqërisë kryhet nga krye shefi ekzekutiv në pajtueshmëri me statutin, aktet ligjore dhe nen ligjore. Po ashtu neni 10 i Ligjit për Trepçën ka përcaktuar shumë qartë se qeverisja e ndërmarrjes Trepça SH.A bëhet nga bordi mbikëqyrës dhe

Bordi menaxhues, andaj duke u bazuar në të lartcekurat shihet qartë se detyrat, përgjegjësit dhe organizimi i shoqërisë kryhet nga krye shefi ekzekutiv.

Sa i përket pretendimeve të palës paditëse duke u thirre në nenin 33 par. 3, konsiderojmë se kjo dispozite vlen për rastet ku një punonjës me vullnet të tij dëshiron të transferohet nga një njësi në njësinë tjetër dhe kërkohet aprovimi dhe kërkesa e udhëheqësit të njësisë, e asesi nuk nënkupton që kryeshefi ekzekutiv duhet të merr një aprovim apo një leje nga një udhëheqës i drejtpërdrejt, e i cili i përgjigjet po të njëjtit kryeshef, andaj duke u bazuar në të lartcekurat konsideroj se Ligji për Trepçës si dhe statuti i saj në dispozitat e saj ka paraparë shumë çartë se mbi kë bie përgjegjësia dhe organizimi i shoqërisë. Sa i përket pjesës se arsytimit të vendimit mbi organizimin e ri të vendeve të punës si dhe informatës të cilën e dorëzojë si prove paditësi, konsiderojmë se këto nuk qëndrojnë pasi që rregullorja për ristrukturimin e Trepça Sh. A ka hyrë në fuqi me datë 03.05.2023, si dhe të gjitha vendimet apo kontratat të cilat i kanë pasur punëtoret e ndërmarrjes kanë ra poshtë dhe është dashur që të merren vendime tjera dhe po ashtu kontrata tjera duke u bazuar në rregulloren për ristrukturim dhe organizim të Trepça Sh.A rregullorja dhe me nr. Protokollit 2776 e datës 26.05.2023, në nenin 4 të saj është parapare përgjegjës për zbatim të saj dhe në të gjitha njësit organizative brenda ndërmarrjes si dhe zbatimin e kësaj rregulloreje e monitoron kryeshefi ekzekutiv.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat konsiderojmë se kryeshefi ekzekutiv në mënyre të drejt ka zbatuar dispozitat ligjore të cilat janë të parapara në Ligjin për Trepçën, statutin e saj si dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes e Trepça SH.A, ashtu që i propozojmë gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tersi si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike Gjykata administroj këto prova: Vendimi i nxjerr nga e paditura me nr . Prot 5794 i datës 25.09.2024, Ankesa e ushtruar nga ana e paditësit me nr. Prot. 6054 i datës 02.10.2024, Vendimi i Komisionit të ankesave me nr. Prot 6285 i datës 06.10.2024, Email-et e datës 25 dhe 26.10.2024, Vlerësimi i kryerjes se punës i datës 11.01.2024, Kontrata e pune me nr. Prot. 997 e datës 19.10.2020 dhe Informata e nxjerr nga e paditura me nr. Prot. 1759 e datës 03.04.2023.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Me leximin e kontratës së punës e lidhur mes palëve e dt. 19.10.2020, konstatohet se paditësi është në marrëdhënie pune me kohe të pacaktuar tek e paditura me pozitën Drejtues i njësisë së përpunimit të xehës -Mineria Trepça SH.A, ku i cili gëzon pagën në lartësi prej 888.00 euro bruto.

Me leximin e vendimit të nxjerr nga e paditura me nr.5794 i datës 25.09.2024 i nxjerr nga U.D i Krye shefit Ekzekutiv të Trepça SH.A, paditësi si Drejtues i njësisë së përpunimit të xehës, nga njësia biznesore Miniera me Flotacion Trepça-Stantërg, transferohet në njësinë biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë si Udhëheqës i procesit Teknologjik.

Me leximin e ankesës së parashtruar nga paditësi e datës 02.10.2024 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka parashtruar ankesë pranë të paditurës, dhe ka kërkuar që të shfuqizojë vendimin e ankimuar dhe paditësi të rikthehet në vendin e punës.

Me leximin e vendimit i nxjerr nga Komisioni i ankesave me nr. të protolollit nr.6285 i datës 15.10.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se Komisioni i ankesave e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar ankesën e datës 02.10.2024.

Nga email-at e dt. 25.10.2024 dhe 26.10.2024, vërtetohet fakti se nuk ka pasur kërkesë nga udhëheqësi i drejtpërdrejt i paditësit, epo ashtu nuk ka pasur kërkesë nga njësia biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë, që të transferohet paditësi nga një njësi në tjetrën.

Nga vlersimi i kryerjes se punëve i nxjerr nga e paditura për paditësin me dt. 11.01.2024 vërtetohet fakti se paditësi ka përmbushur detyrat e tij të punë dhe ka pasur performancë prej 95.2%.

Si çështje kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse është paraqitur fakti se paditësi pretendon se në mënyrë të kundërligjshme e paditura e ka sistemuar nga Drejtues i njësisë së përpunimit të xehës, nga njësia biznesore Miniera me Flotacion Trepça-Stantërg, transferohet në njësinë biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë si Udhëheqës i procesit Teknologjik e po ashtu vendimin e ka nxjerr e paditura pa kërkesë dhe aprovim të udhëheqësit të drejtpërdrejt të punonjësit dhe në kundërshtim me Ligjin e Punës, kurse e paditura pretendon se vendimet e nxjerra nga ana e sajë janë në harmoni me ligjin dhe nxjerr nga personi kompetent.

Baza juridike dhe vlerësimet e gjykatës.

Gjykata gjeti se paditësi komfor dispozitave ligjore konkretisht nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, i ka plotësuar kushtet ligjore për të iniciuar kontest pune në gjykatë. Padia është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Me provat e administruara, gjykata ka gjetur se paditësi me vendimin me nr. protokollit 5794 i dt. 25.09.2024 është sistemuar në njësinë biznesor Miniera me Flotacion në Kishnicë dhe Artanë me arsyetim se vendimi është bazuar në Rregulloren për sistematizim në vendin e punës nga udhëheqësi i njësisë biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stantërg, në emër të ristrukturimit dhe organizimit të ri të ndërmarjes.

Në vlerësimin e gjykatës, e paditura nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të Rregullores për marrëdhënien e punës në Trepça SH.A, kur e ka transferuar në pozitë tjetër në njësinë biznesore në Kishnicë dhe Artanë, në kundërshtim me nenin 33 par. 3 të Rregullores për marrëdhënien e punës në Trepça SH.A, andaj në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e njëjta duhet të aprovohet sikurse në dispozitive të këtij aktgjykimi.

E paditura, fillimisht në kundërshtim me dispozitat ligjit të Punës dhe Rregullores për marrëdhënien e punës në Trepça SH.A, nxjerr vendim për sistematizim e punonjësit në vendin e punës, ku ma konkretisht neni 17 par.1 i ligjit të punës parasheh se “ I punësuar i caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune”, Par. 2. I po të njëjtit nen parasheh se “Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuar i pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës”,

Po ashtu par. 3. i ligjit të lartcekur parasheh se “I punësuar sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive”.

Neni 33 i Rregullores për marrëdhënien e punës në Trepça SH.A parasheh se “I punësuar duhet të sistemohet në vendin e punës për të cilin ka lidhur kontratë pune”, par.2 i po të njëjtit nen parasheh kushtet kur mund të sistemohet dhe si mund të sistemohet një i punësuar, kurse par.3 i po të njëjtit nen parasheh se “Me kërkesën e udhëheqësit të njësisë biznesore dhe aprovimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të punonjësit, mund të bëhet transferimi i punonjësit nga një njësi biznesore në tjetrën, i cili bëhet me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv”.

Në rastin konkret në pozitën e punës që ka qenë i punësuar paditësi, kontratën e ka nënshkruar UD i Kryeshefit Ekzekutiv të Trepça SH.A, po ashtu Kryeshefi Ekzekutiv me vendim e ka transferuar nga një njësi biznesore në tjetrën, mirëpo me rastin e nxjerrjes së vendimit nga e paditura edhe pse është nxjerr nga personi kompetent, mirëpo është nxjerr në kundërshtim me nenin 33 par.3 të Rregullores për marrëdhënien e punës në Trepça SH.A, pasi që si kusht për tu transferuar një i punësuar nga një njësi biznesore në tjetrën është: 1. Të ketë kërkesë nga udhëheqësit të njësisë biznesore, që në rastin konkret e paditura nuk e ka dëshmuar që ka pasur kërkesë nga njësi biznesore në Kishnicë dhe Artanë, si dhe kushti 2. Të ketë aprovimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të punonjësit, e që ka qenë Udhëheqësi i njësisë biznesore Miniera me Flotacion Stanterg, i cili udhëheqës përmes përgjigjes në email-in te dt. 26.10.2024 e ka vërtetë se nuk ka pasur kërkesë e as aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i paditësit, ku ne vendimin e dt. 25.09.2024 si arsyetim i transferimit është dhënë arsyetimi i ristrukturimit dhe riorganizimit të vendeve të punës, e konform nenit 322 të LPK-së palët ndërgjyqëse duhet ti mbështesin pretendimet e veta me prova.

Meqenëse gjykata i anuloi si të kundërligjshme vendimet e lartcekura pasi që të njëjta janë nxjerr në kundërshtim me aktet normative të nxjerra nga e paditura, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe në mbështetje të nenit 5 të Ligjit të Punës, gjykata vendosi si në piken II të dispozitivit duke e obliguar të paditurën, që paditësin ta kthej në vendin paraprak të punës, e në pajtim me Kontratën e punës të dt. 19.10.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore.

Lartësia e shpenzimeve të aprovuara si në piken III të dispozitivit i referohet dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104€, në emër të taksës për padi shumen prej 20€ dhe në emër të dy seance gjyqësore të mbajtura shumë prej 270.00 €, apo në shumë të përgjithshme prej 394.00€.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.4334/2024 dt. 23.12.2024**

**Gjyqtari**  
Blerim Istrefi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë.